DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0-355/1
Data Datum Date 17.06.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Gazmend Muhaxheri,** Kryetar i Komunës së Pejës<br>**Islam Husaj,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Goran Rakić,** Zëvendëskryeministër dhe Ministër në MPL<br>**Rozafa Ukimeraj,** Sekretare e Përgjithshme në MPL | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqës e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 11.06.2020<br>Nr.0-355 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Pejës | |
| Lloji i aktit: | □ Rregullore e Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Rregullore Nr.01/2020 për Organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Pejës |
| I miratuar më datë:29.05.2020 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 02.06.2020 |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural <u>**është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**</u> dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALJSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0-355/1
-VI-
Data Datum Date 17.06.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Uprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Gazmend Muhaxheri,** gradonačelnik opštine Peć<br>**Islam Husaj,** predsedavajući Skupštine opštine Peć | |
| Kopije: | Jedinici za administraciju dokumenata u MLU-e<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko:: | **Goran Rakić,** ministar MLU-e<br>**Rozafa Ukimeraj,** generalna sekretarka MLU-e, | |
| Od: | **Venera Çerkini,** rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MLU | Dana, 11.06.2020 br. 0-553 |
| Odgovni službenici:<br>1. Službenik-ca za potvrđivanje pravne procene:<br><br>2. Službenik-ca za izradu pravne procene: | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br><br>Sanije Dërguti, viša službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda o zakonitosti akta Skupštine opštine Peć | |
| Vrsta odluke: | □Uredba Skupštine opštine | |

Uvaženi gradonačelniče,

Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstava određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MLU-e, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-40 o lokalnoj samoupravi opštinskog akta kao u nastavku:

| |
|---|
| Uredba br.01/2020, za organizaciju i saradnju opštine sa selima, naseljima i gradskim četvrtima na teritoriji opštine Peć |
| Usvojena dana, 29.05.2020.godine, |
| Predložena za razmatranje u MLU-e dana, 02.06.2020.godine, |

Ministarstvo lokalne uprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je <u>opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni efekat.</u>
Ministarstvo lokalne uprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

**KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ**

HYRESE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date 02.06.2020
-VI- 0-355

# RREGULLORE (KPE) NR. 01/2020
# PËR
# ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PEJËS

**Maj. 2020**

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**
**I.Numër:352-01/21640, me dt. 29. Maj 2020**

Në bazë të neni 12, paragrafi 12.2, shkronja c), nenit 17 paragrafi 1 pika s), nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008 e dt.04. qershor 2008"), nenit 4 të Udhëzimit Administrative (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimit dhe lagjet urbane dt. 28.06.2019, dhe të nenit 9, paragrafi 1, shkronja c), nenit 14,paragrafi 1 shkronja s) dhe nenin 17, të Statuti të Komunës së Pejës 01 Nr. 09-8103, të datës: 29. Shtator 2008, Kuvendi i Komunës së Pejës, në mbledhjen e mbajtur me 29 Maj 2020, miratoi këtë

# RREGULLORE (KPE) NR. 01/2020
# PËR
# ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PEJËS

## Neni 1
## Qëllimi

1.1 Kjo rregullore ka për qëllim të rregulloj organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatar, vendbanime dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të parashikuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale.

## Neni 2
## Fushëveprimi

2.2 Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis Komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duke formuar këshilla lokale, si trupa mbështetës të Komunës dhe që të ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrjes.

## Neni 3
## Formimi i këshillave lokale

3.1 Për të realizuar sa më mirë funksionet dhe përgjegjësit e parapara më Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Komuna e Pejës do të mbështesë zgjidhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetaret e këshillave lokale. Një këshill lokale mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

3.2 Numri i këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane, do të themelohen në nivele të këshillave lokale dhe janë parashikuar ne nenin 4 paragrafi 4.9 të kësaj rregulloreje.

**Neni 4**
**Formimi i komisionit nga Kuvendi i Komunës për përzgjedhjen këshillave lokale**

4.1 Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punen në terren në zgjidhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet te këtë shtatë ( 7) anëtar, katër (4) anëtar nga Kuvendi i Komunës, një (1) anëtar nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Nga shtatë (7) anëtaret e komisionit tre (3) duhet te jenë femra si dhe një (1) anëtar patjetër të jetë e komunitetit jo shumicë. Përbërja e komisionit duhet te përfaqësoj përbërjen e subjekteve politike me numër më te madh të anëtrave të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtaret e Komisionit. Komisioni i raporton Kuvendit për procesin zgjedhor. Mandati i komisionit është lidhur me mandatin e Kuvendit te Komunës.

4.2. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtje se tubimeve me qytetarë, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

4.3 Se paku katër (4) anëtar të komisionit të Kuvendit të Komunës, duhet te jenë të pranishëm në të gjitha tubimet zgjedhor që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.

4.4 Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetrarëve të këshillave lokale.

4.5 Të gjithë qytetarët pjesëmarrës në tubimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhor. Komisioni i emëruara nga Kuvendi i Komunës, është i obliguar që ti shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej 15 ditëve nga data e parashtrimit të kërkesës, tu kthej përgjigje më shkrim atyre që kanë adresuar ankesën.

4.6 Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, përmes zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:

4.6.1 shpalljeve publiket vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet për zgjedhjen e këshillave lokale;
4.6.2 medieve lokale;
4.6.3 web-faqes zyrtare të Komunës.

4.7 Njoftimi për publikun duhet te përmbajë:

4.7.1 rendin e ditës;
4.7.2 datën
4.7.3 kohen dhe

4.7.4 vendin e mbajtjes së tubimet.

4.8 Pas përfundimit të procesit zgjedhor të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale, komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës pushona aktivitetin.

4.9 **Në territorin e Komunës së Pejës, formohen këto këshilla lokale si me poshtë.**

4.9.1 Këshilli lokal i fshatrave: Raushiq, Zllapek, Loxhë, Lybeniq, Zagermë dhe Bellopoj.
4.9.2 Këshilli lokal i fshatrave: Kryshec, Rshiq, Broliq, dhe Duboqak.
4.9.3 Këshilli lokal i fshatrave: Baran i ultë, Baran i epërm, Turjak, Kotradiq, Vranoc, Rosujë, Çallapek, Buqan,
4.9.4 Këshilli lokal i fshatrave:Gllogjan, Kosuriq, LLugaxhi dhe Nepole,
4.9.5 Këshilli lokale i fshatrave: Poqest, Vragoc, Millovanc, Babiq, Kërstoc, Pishtan dhe Gorazhdec
4.9.6 Këshilli lokal i fshatrave: Zahaq, Ramun, Llabjan dhe Nakëll,
4.9.7 Këshilli lokal i fshatrave: Leshan, Gllaviqic, Sverk, Jabllanicë, Kliqin dhe Rosule,
4.9.8 Këshilli lokal i fshatrave: Treboviq, Katundi i Ri, Pavlan dhe Bllagajë,
4.9.9 Këshilli lokal i fshatrave: Nabërgjan, **Llugat e Drini (ana e majtë) Osojë** dhe Çungur,
4.9.10 Këshilli lokal i fshatrave:Trestenik, Ruhot dhe Lutogllav,
4.9.11 Këshilli lokal i fshatrave: Radavc, Novoseli, Jabllancë e vogel dhe Jabllanicë e madhe,
4.9.12 Këshilli lokal i fshatrave: Ozdrim dhe Dubov,
4.9.13 Këshilli lokal i fshatrave: Vitomirice,
4.9.14 Këshilli lokal i fshatrave: Lipe, Brestovik dhe Sigë,
4.9.15 Këshilli lokal i fshatrave: Llozhan, Graboc, Dobërdol
4.9.16 Këshilli lokal i fshatrave: Bogë, Koshutan, Haxhaj, Kuqisht, Joshanicë (Stankaj), Shkrel dhe Dugaiv,
4.9.17 Këshilli lokal i fshatrave: Drelaj, Pepiq, Malaj, Shtupeq i vogel, Shtupeq i madh, Llaz-Bellopaq, Reka e Allagës,
4.9.18 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Sahat Kullë
4.9.19 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Qendra,
4.9.20 Këshilli lokal i lagjeve urbane: 2 Korriku,
4.9.21 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Kapeshnica
4.9.22 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Karagaqi
4.9.23 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Haxhi Zeka
4.9.24 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Xhemajl Kada
4.9.25 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Rrokaqelli
4.9.26 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Kristali
4.9.27 Këshilli lokal i lagjeve urbane: 7 Shtatori
4.9.28 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Dardani I
4.9.29 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Dardani II
4.9.30 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Dardania III.

## Neni 5
## Formimi i këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes

5.1 Këshilli i lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të ketë nga 5 (pesë) deri 9 (nëntë) anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshillë lokal, përcaktohet nga vetë banoret e fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.

5.2 Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal. Në taste kur këshilli lokal ka numër qift të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, fshati, vendbanimi apo lagja urbane me numër me te madha të banorëve jep dy anëtar në këshillin lokal.

5.3 Përbërja e këshillave lokale duhet te reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30% të gjinisë femërore, sipas Ligjit për barazi gjinore. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane jetojnë pjesëtar të komuniteteve joshumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal nëse janë të pranishëm në tubim. Nëse kemi më shumë se një komunitet të pakicës, komuniteti që ka shumicën duhet të përfaqësohet në këshillin lokal.

5.4 Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës zgjedhin anëtarët e këshillit lokal më rastin e tubimit të qytetarëve, që mblidhen të gjithë banorët e interesuar të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane.

5.5 Zgjedhja behët përmes votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve.

5.6 Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë banorë të përhershëm në atë lokalitet.

5.7 Kandidatët për pozita të anëtareve dhe të kryetarëve të këshillave lokale nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur në poste politike.

5.8 Anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, zgjidhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.

5.9 Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, kandidati i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim.

5.10 Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo me shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë organizohen rrethi i dyte i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjidhet për anëtar, kryetar i këshillit lokal.

5.11 Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç të atij lokaliteti. Numri i kandidatëve të propozuar për këshill lokal duhet të jetë me lartë se numri i përcaktuar për tu zgjedhur.

5.12 Anëtaret dhe kryetaret e këshillave lokale të fshatit, vendbanimeve dhe logjeve urbane, zgjidhen me mandate 4 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandate.

5.13 Tubimet kanë legjitimitet juridik, nëse në tubime janë të pranishëm se paku 50 pjesëmarrës më të drejtë vote të atij lokaliteti, që duhet përfshijë së paku 30% të gjinisë femërore.

**Neni 6**
**Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetareve të këshillave lokale**

6.1 Në raste kur qytetarët konsiderojnë se anëtaret ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushur obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtaret dhe kryetari i këshillit mund të shkarkohet me shumicën e votave të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane më rastin e tubimit publik me qytetarë.

6.2 Në mënyrë që të bëhet ky votim, kërkohet një peticion për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ky peticion duhet te mbledh nënshkrimet e më shumë se gjysmë numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Peticioni protokollohet dhe i dorëzohet Drejtorisë së Administratës dhe sektorit për punët e Kuvendit, të cilët pastaj e procedojnë tek anëtaret e Komisionit të formuar sipas nenit 4 pika 1, të cilët anëtarë duhet të lajmërohen paraprakisht për një mbledhje të tillë.

6.3 Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet sipas procedurave të parapara në paragrafin 2, një votim i ri duhet të behët menjëherë, në bazë të procedurave të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në mënyre që të zgjidhet një këshill i ri lokal. Rezultatet e votimit duhet të raportohen në bazë të kërkesave të nenit 6 të kësaj rregulloje.

6.4 Mandati i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokalë përfundon:

6.4.1 me kryerjen e mandatit;
6.4.2 nëse vdes;
6.4.3 nëse jep dorëheqje;
6.4.4 nëse ndërron vendbanim;
6.4.5 nëse shkarkohet;
6.4.6 nëse kryen vepër penale dhe me vendim të formës se prere dënohet me burgime për tre (3) muaj ose me tepër.

**Neni 7**
**Procesverbali nga tubimi zgjedhor**

7.1 Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përmbajë datën, orën dhe vendi i mbajtjes së tubimit, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, listën e pjesëmarrësve, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.

7.2 Procesverbalin e nënshkruajnë Kryesuesi i tubimit, anëtaret e komisionit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, i raporton Kuvendit te Komunës për rrjedhën e tubimit dhe për zgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane.

7.3 Rezultate e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve dhe te kryetarit të këshillit lokal, duhet të bëhen publik menjëherë pas tubimit zgjedhor.

## Neni 8
## Konsultimet ndërmjet Komunës dhe këshillave lokale

8.1 Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtori për Administratë, ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet rregullat publike, takimet për planifikim të politikave zhvillimore komunale që organizohen nga organet komunale.

8.2 Së paku një anëtar i këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, duhet të jetë I përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për planifikim të planeve urbane, zhvillimore dhe rurale qe janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.

8.3 Kryetari i Komunës duhet te organizoj se paku dy takime ne vit me udhëheqësit e këshillave lokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj. Për rendin e ditës duhet të konsultohet edhe udhëheqësit e këshillave lokale.

8.4 Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

## Neni 9
## Bartja e aktiviteteve nga Komuna te këshillat lokale

9.1 Me kërkesë të këshillit lokal dhe rekomandimin e Kryetarit te Komunës apo ndonjë komiteti të Kuvendit, Kuvendi i Komunës me vendim mund të bartë disa përgjegjësi për ti ushtruar këshillat lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të transferohen, duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të Komunës.

9.2 Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane duhet të konsultohet dhe pranoj bartjen aktiviteteve nga Kuvendi Komunës ne këshillin lokal.

9.3 Në rast të bartjes se aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, Komuna do të angazhohet të ofrojë mbështetje dhe burime të mjaftueshme për zyrat lokale/këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartura.

## Neni 10
## Roli,detyrat dhe përgjegjësit e këshillave lokale

10.1 Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të takohen në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet me interes të lokalitetit si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.

10.2 Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urban, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat ne bashkëpunim më Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit, komitetet dhe drejtoritë komunale.

10.3 Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane duhet te informojë komunën për kohen dhe agjendën e takimeve. Zyrtare kompetent komunale mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.

10.4 Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

10.5 Këshilli lokal mund të ndërmarrë aktivitetet, të cilat në veçanti ndikojnë në:

- 10.5.1 zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
- 10.5.2 planifikimin urban dhe rural të lokalitetit
- 10.5.3 mbrojtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;
- 10.5.4 rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
- 10.5.5 sigurimin e të dhënave elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
- 10.5.6 mirëmbajtjen e varreza edhe hapësirave publike të gjelbëruara;
- 10.5.7 zhvillimin e turizmit
- 10.5.8 organizimin aktiviteteve kulturore dhe sportive;
- 10.5.9 bashkëpunimin me organet e Komunës dhe organizatat të tjera të shoqërisë civile për çështjet me interes për lokalitetin;
- 10.5.10 organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin;
- 105.11 zbatimin e aktiviteteve që janë bartur, sipas procedurave të nenit 8 të kësaj rregulloreje.

10.6 Me vendimin e Kryetarit të Komunës, një anëtar i këshillit lokal mund të jetë pjesë e organeve mbikëqyrëse për monitorimin, zbatimin e projekteve për investime kapitale në lokalitetet e tyre.

10.7 Këshillat lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës përkatëse.

10.8 Këshillat lokale kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë më shkrime organeve kompetente të Komunës për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit kurse organet e Komunës brenda afatit 45 ditë i përgjigjen me shkrime këshillit lokal qe ka parashtruar kërkesën.

## Neni 11.

11.1. Këshillat lokale duhet që në afat prej 30 ditësh nga themelimi i tyre, të organizojnë dhe bëjnë zgjedhjen e Nënkëshillave lokal në çdo fshat apo lagje.
11.2. Nënkëshillat lokale zgjedhën në procedurën e njëjtë si këshillat lokale, ku pjesëmarrja në zgjedhje duhet të jetë së pakut 20 qytetar me të drejtë vote.
11.3. Nënkëshillat numërojnë 3 deri në 5 anëtarë.

## Neni 12
## Roli i kryetarëve të këshillave lokale

12.1 Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e Komunës. Kryetari i Këshillit lokal ka obligim ti informoj anëtaret e Këshillit për rezultatet ose konkluzionet nga takimet e përshkruara në paragrafin paraprak.

12.2 Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjen e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit. Po ashtu, ai i nënshkruan konkluzionet dhe propozimet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar qe në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të tyre ti dorëzoj te Kryetari i Komunës.

## Neni 13
## Financimi i aktiviteteve

13.1 Financimi i aktiviteteve të këshillave lokalë mund të bëhet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga Komuna, nga financimi i përbashkët si dhe nga donatoret, në pajtueshmëri të plotë më Statutin, rregulloret komunale dhe legjislacion e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.

13.2 Këshilli lokal përgatit raportet gjashtëmujore dhe vjetore të mjeteve të arkëtuara dhe mjeteve të shpenzuara dhe i bën ato transparentet për qytetarët e atij lokaliteti dhe organet komunale.

## Neni 14
## Kompensimi i këshillave lokale

14.1 Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, përcaktohet nga Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë.

## Neni 15
## Mos përmbushja e përgjegjësive

15.1.Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi ligjore për të gjitha aktivitetet e bartura nga Kuvendi i Komunës në këshillin lokal.

**Neni 16**
**Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare**

16.1 Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e Ligjit apo Statutit.

16.2 Me hyrje ne fuqi te kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e këshillave lokale të Komunës së Pejës, I.Nr:06-2600 e datës 14. maj 2013 dhe Rregullore Komunale Nr. 04/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores I.Nr.06-2600 e dt. 14. maj 2013 për organizimin dhe funksionimin e këshillave lokale në Komunën e Pejës.

**Neni 17**
**Plotësimet, ndryshimi dhe zbatimi**

17.1 Ndryshmet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjte të aprovimit të kësaj rregulloreje.

17.2 Për zbatimin e kësaj rregullore do te kujdesct Kryetari i Komunës dhe Drejtori për Administratë.

**Neni 18**
**Hyrja ne fuqi**

18.1.Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

**KRYESUESI I KUVENDIT**
**Dr. Islam Husaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

OPŠTINA PEĆ/ MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Goverment Administration
Data / Datum / Date 02.06.2020
-07-0-3555

**PRAVILNIK (OKS) BR. 01/2020**
**O**
**ORGANIZACIJI I SARADNJI OPŠTINE SA SELIMA, NASELJIMA I PRIGRADSKIM NASELJIMA NA TERITORIJI OPŠTINI PEĆ**

**Maj, 2020**

**SKUPŠTINA OPŠTINE**
**I.Broj: 352-01/21640,dt. 29. Maja 2020**

Na osnovu člana 12, stav 12.2 slovo c), člana 17 stav 1 slovo s) i člana 34, stav 34.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi ("Sluzbeni List Republike Kosova, Br.28/2008 od 04.juna 2008"), člana 4 Administrativnog uputstva (MALV) Br.02/2019 o Organizaciji, funkcionisanju i saradnji Opština sa selima, naseljima i prigradskim naseljima, i člana 9 stava 1 slovo c) i člana 17, statuta Statuta Opštine Peć 01.Broj:09-8103, od 29.septembra 2008 godine, Skupština Opštine Peć, na sastanku održanom dana 29. maja 2020 godine, usvojila je :

# PRAVILNIK (OKS) BR. 01/2020
# O
# ORGANIZACIJI I SARADNJI OPŠTINE SA SELIMA, NASELJIMA I PRIGRADSKIM NASELJIMA NA TERITORIJI OPŠTINI PEĆ

## Član 1
## Cilj

1.1 Cilj ovog pravilnika jeurediti organizaciju i saradnju Opštine sa selima, naseljima i prigradskim naseljima na teritoriji opštine, u obavljanju aktivnosti koje su isključivo u vlastitoj nadležnostiopština, predviđenih Zakonom o Lokalnoj Samoupravi.

## Član 2
## Oblast primene

2.1 Ovaj pravilnik uređuje način organizacije i saradnju Opštine sa selima, naseljimai prigradskim naseljima formirajući lokalne odbore, kao tela za podršku Opštini koja utiču na sveobuhvatne konsultacije, koje promovišu i razvijaju transparentnost, odgovornost i učešće građana u procesu odlučivanja.

## Član 3
## Formiranje lokalnih odbora

3.1 Za što bolje ostvarivanjefunkcija i odgovornosti predviđenih Zakonom o Lokalnoj Samoupravi, Opština Peć će podržavati izborlokalnih odbora sela, naselja i prigradskih naselja i predsedavajućih lokalnih odbora. Jedan lokalni odbor može obuhvatiti jedno i više sela, naselja i prigradskih naselja.

3.2 Broj lokalnih odbora sela, formalnih i neformalnihnaselja i prigradskim naseljima, formiraće se na nivou lokalnih odbora i predviđen je članom 4, stav 9 ovog pravilnika.

## Član 4
## Formiranje komisije od Skupštine Opštine za izbor lokalnih odbora

4.1 Skupština Opštineimenuje jednu komisiju za vođenje i koordinaciju rada na terenu za izbor lokalnih odbora.Komisija treba da ima sedam (7) članova, četiri (4) člana iz Skupštine Opštine, jedan (1) član iz izvršne vlasti, jedan (1) iz civilnog društva i jedan (1) predstavnik sela, naselja ili prigradskog naselja. Od sedam (7) članova komisije tri (3) treba da budu žene i jedan (1) član treba da bude iz nevećinske zajednice. Sastav komisije treba da predstavlja strukturu Skupštine i političke subjekte sa najvećim brojem članova u Skupštini Opštine. Predsedavajućeg komisijebiraju članovi komisije. Komisija izveštava Skupštini o izbornom procesu. Mandat komisije vezuje se za mandat Skupštine Opštine.

4.2 Imenovana komisija odSkupštine Opštinetreba da bude odgovorna za određivanje vremena održavanja skupova sa građanima, za izbor članova lokalnih odbora i predsedavajućeg lokalnih odborasela, naselja i prigradskih naselja.

4.3 Najmanje (4) članova komisije Skupštine Opštinetrebaju biti prisutni na svim izbornim skupovima koji se organizuju za izbor lokalnih odbora.

4.4 Imenovana komisija odSkupštine Opštinei predstavnici sela, naselja i prigradskih naselja, sarađuju da bi organizovali izbor članova lokalnih odbora i predsedavajućih lokalnih odbora.

4.5 Svi građani učesnici u izbornim skupovima mogu podneti svoje žalbe, ako konstatuju nepravilnosti u toku izbornog procesa. Imenovana komisija odSkupštine Opštineima obavezu da razmotri sve žalbe i da u roku od 15 dana od datuma predatog zahtevadostavi odgovor u pismenoj formi onima koji su podneli žalbu.

4.6 Imenovana komisija odSkupštine Opštine, preko kancelarije za informisanje, informiše građane 15 dana pre dana održavanja skupa građana za izbor lokalnih odbora putem:

- 4.6.1 Javnih oglasa postavljenih u javnim objektima i na najposećenijim mestima na teritoriji gde se održavaju skupovi;
- 4.6.2 Lokalnih medija;
- 4.6.3 Preko zvaničneweb-stranice Opštine.

4.7 Obaveštenje za javnost treba da sadrži:

- 4.7.1 Dnevni red
- 4.7.2 Datum
- 4.7.3 Vreme i
- 4.7.4 Mesto gde će se skup održati.

4.8 Nakon završetka izbornog procesa lokalnih odbora i predsedavajučeg lokalnih odbora, formirana komisija od strane Skupštine Opštinezavršava aktivnost.

**4.9. Na teritoriji Opštine Peć, formiraju se lokalni odbori na sledeći način:**

4.9.1 Lokalni odbor sela:Raušić, Zlopek, Loda, Ljubenić, Zagermije i Belo Polje.
4.9.2 Lokalni odbor sela:Krušec, Raušić, Brolić i Dubočak.
4.9.3 Lokalni odbor sela:Donje Barane, Gornje Barane, Turjak, Kotradić, Vranoc, Rosulje, Čelopek, Bučan,
4.9.4 Lokalni odbor sela:Glođan, Kosurić, Lugadžije i Nepolje,
4.9.5 Lokalni odbor sela:Počešće, Vragoc, Milovance, Babić, Krstovac, Pištane i Goraždec
4.9.6 Lokalni odbor sela:Zahać, Ramun, Labljane i Naklo,
4.9.7 Lokalni odbor sela:Lješane, Glavičica, Sverka, Jablanica, Kličina i Rosulje,
4.9.8 Lokalni odbor sela:Trebović, Pašino selo, Pavljan i Blagaje,
4.9.9 Lokalni odbor sela:Nabrđane, Lugovi Drina (leva strana) Osojei Čungur,
4.9.10 Lokalni odbor sela:Trestenik, Ruhot i Ljutoglava,
4.9.11 Lokalni odbor sela:Radavac, Novoselo, Mala Jablanica i Velika Jablanica,
4.9.12 Lokalni odbor sela:Ozdrim i Dubovo,
4.9.13 Lokalni odbor sela:Vitomirica,
4.9.14 Lokalni odbor sela:Lipa, Brestovik i Siga,
4.9.15 Lokalni odbor sela:Ložane, Grabovac, Dobri Do
4.9.16 Lokalni odbor sela:Bog, Košutan, Hadžaj, Kućište, Jošanica (Stankaj), Škrelje i Dugaivo,
4.9.17 Lokalni odbor sela:Drelaj, Pepić, Malaj, Mali Štupeć, Veliki Štupćč, Laz-Belopać, Alagina Reka,
4.9.18 Lokalni odbor prigradskih naselja:Sahat Kula
4.9.19 Lokalni odbor prigradskih naselja:Centar,
4.9.20 Lokalni odbor prigradskih naselja:2 Juli,
4.9.21 Lokalni odbor prigradskih naselja:Kapešnica
4.9.22 Lokalni odbor prigradskih naselja:Karagač
4.9.23 Lokalni odbor prigradskih naselja:Hadži Zeka
4.9.24 Lokalni odbor prigradskih naselja:Xhemajl Kada
4.9.25 Lokalni odbor prigradskih naselja:Soliter
4.9.26 Lokalni odbor prigradskih naselja:Kristal
4.9.27 Lokalni odbor prigradskih naselja:7 Septembar
4.9.28 Lokalni odbor prigradskih naselja:Dardanija I
4.9.29 Lokalni odbor prigradskih naselja:Dardanija II
4.9.30 Lokalni odbor prigradskih naselja:Dardanija III.

## Član 5
## Formiranje lokalnih odbora i kriterijumi izbora

5.1 Lokalni odbor sela, naselja i prigradskih naselja mogu imati od pet (5) do devet (9) članova. Tačan broj članova za svaki lokalni odbor, reguliše se od samih stanovnika sela, naselja i prigradskih naselja koji su prisutni na izbornom skupu.

5.2 Svako selo, naselje ili prigradsko naselje treba biti predstavljeno u lokalnom odboru. U slučaju kada lokalni odbor ima paran broj sela, naselja i prigradskih naselja, selo, naselje ili prigradsko naselje sa većim brojem stanovnika daje dva člana lokalnog odbora.

5.3 Sastav lokalnog odbora treba da prikaže etnički i rodni sastav. U sastavu lokalnog odbora treba da bude minimum 30% osoba ženskog roda, prema zakonu o rodnoj ravnopravnosti. U slučaju kada u selu, naselju ili prigradskom naselju žive pripadnici nevećinskihzajednica, oni treba da budu predstavljeni u lokalnom odboru ako su prisutni na skupu. Ako imamo više od jedne nevećinske zajednice, zajednica koja ima većinu treba se predstaviti u lokalnom odboru.

5.4 Sela, naselja i prigradska naselja Opštine biraju članove lokalnog odbora na skupu građana, gde se skupljaju svi zainteresovani stanovnici sela, naselja i prigradskih naselja.

5.5 Izborse vrši putem tajnog glasanja na skupu građana.

5.6 Kandidati za članove lokalnog odbora treba da budu stalni stanovnici te lokacije.

5.7 Kandidati za pozicije članova i predsedavajućih lokalnih odbora ne mogu biti lica koja su izabrana za političke pozicije.

5.8 Za članove lokalnih odbora sela, naselja i prigradskih naselja, biraju se kandidati koji dobiju najveći broj glasova ukupnog broja stanovnika sela, naselja ili prigradskih naselja, koji su prisutni na izbornom skupu.

5.9 Predsedavajući lokalnog odbora bira se među članovima lokalnih odbora sela, naselja ili prigradskih naselja, kandidat koji dobije većinu glasova građana koji učestvuju na tom skupu.

5.10 Ako na prvom krugu glasanja imamo dva ili više kandidata sa istim brojem glasova, tada se organizuje drugi krug glasanja i kandidat sa većim brojem glasova bira se za člana/predsedavajućeg lokalnog odbora.

5.11 Pravo glasa imaju svi stanovnici te lokacije stariji od 18 godina. Broj predloženih kandidata za lokalni odbor treba biti veći od predviđenog broja koji treba da se izabere.

5.12 Članovi i predsedavajući lokalnih odbora sela, naselja i prigradskih naselja, biraju se za mandat od 4 godine, uz mogućnost ponovnog izbora za još jedan mandat.

5.13 Skup ima pravni legitimitet, ako je na skupu prisutno najmanje 50 učesnika te lokacije sa pravom glasa, što obuhvata najmanje 30% ženskog roda.

## Član 6
## Prekid i prestanak mandata članova i predsedavajućih lokalnih odbora

6.1 U slučajevima kada građani smatraju da članovi ili predsedavajući lokalnog odbora ne ispunjavaju obaveze koje proizilaze iz ovog Pravilnika, članovi i predsedavajući mogu biti smenjeni većinom glasoba stanovnika sela, naselja ili prigradskih naselja na skupu sa građanima.

6.2 Da bi se obavilo glasanje, zahteva se peticija za prekidanje mandata kou treba da potpišu stanovnici sela, naselja ili prigradskog naselja. Peticiju treba da potpiše najmanje polovina učenika na skupu na kome je izabran lokalni odbor. Peticija se protokoliše i dostavlja Direktoratu za Administraciju i sektoru za skupštinske poslove, a zatim se prosleđuje članovima Komisije prema članu 4 tačka 1, a članovi treba prethodno da najave takav skup.

6.3 U slučaju da lokalni odbor bude smenjen prema postupku u stavu 2, novo glasanje treba da se obavi odmah na osnovu postupka iz člana 5 ovog Pravilnika, da bi se izabrao novi lokalni odbor. Rezultati glasanja treba da se objave na osnovu zahteva iz člana 6 ovog Pravilnika.

6.4 Mandat predsedavajućeg i članova lokalnih odbora se završava:

6.4.1 Završetkom mandata;
6.4.2 Smrću;
6.4.3 Ako da ostavku;
6.4.4 Ako promeni prebivalište;
6.4.5 Ako bude smenjen;
6.4.6 Ako izvrši krivično delo i pravosnažnom presudom bude kažnjen zatvorom u trajanju od 3 (tri) meseca i duže

## Član 7
## Zapisnik sa izbornog skupa

7.1 Zapisnik koji je sastavljen na skupu sa građanima treba da sadrži datum, vreme i mesto održavanja skupa, broj građana koji su učestvovali na skupu, listu učesnika, podatke o izboru članova i predsednika lokalnih odbora, postupak glasanja i druga pitanja u vezi skupa.

7.2 Zapisnik potpisuje Predsedavajući skupa, članovi Komisije i zapisničar, a komisija određena u članu 4 ovog Pravilnika izveštava skupštini Opštine o toku sastanka za izbor lokalnih odbora sela, naselja i prigradskih naselja.

7.3 Rezultati izbora, imena članova i predsedavajućih lokalnog odbora treba da se objave odmah posle izbornog skupa.

## Član 8
## Konsultacije između Opštine i lokalnih odbora

8.1 Gradonačelnik Opštine, Predsedavajući Skupštine i Direktor Administracije pozivaju predstavnike sela, naselja ili prigradskih naselja da učestvuju na javnim skupovima sa građanima, na javnim raspravama o budžetu, na redovnim javnim skupovima, skupovi za planiranje razvojnih opštinskih politika koje organizuju opštinski organi.

8.2 Najmanje jedan član lokalnog odbora sela, naselja ili prigradskih naselja treba da bude uključen u sve opštinske radne grupe za sastavljanje urbanističkih, razvojnih i ruralnih planova za lokalitet gde žive.

8.3 Gradonačelnik Opštine treba da organizuje bar dva sastanka sa rukovodiocima lokalnih odbora. Sastanak treba da se održi najmanje jednom u 6 meseci. O dnevnom redu treba da se konsultuje sa rukovodiocima lokalnih odbora.

8.4 Skupština Opštine može tražiti mišljenje od lokalnog odbora sela, naselja ili prigradskog naselja u vezi određenih pitanja u interesu zajednice.

**Član 9**
**Prenos aktivnosti Opštine lokalnim odborima**

9.1 Na zahtev lokalnog odbora i po preporuci Gradonačelnika Opštine ili nekog drugog Skupštinskog Komiteta, Skupština Opštine odlukom može preneti neke odgovornosti lokalnim odborima sela, naselja ili prigradskih naselja. Aktivnosti koje se mogu preneti treba da budu u isključivoj nadležnosti Opštine.

9.2 Lokalni odbor sela, naselja ili prigradskih naselja treba da se konsultuje i prihvati prenesene aktivnosti od strane Skupštine Opštine

9.3 U slučaju delegiranja aktivnosti Opštine lokalnim odborima, Opština će se angažovati da pruži podršku i dovoljno izvora za mesne kancelarije/seoske odbore, naselja i prigradska naselja sa ciljem ispunjavanja prenesenih aktivnosti.

**Član 10**
**Uloga, zadaci i odgovornosti lokalnih odbora**

10.1 Lokalni odbor sela, naselja ili prigradskih naselja mogu se sastati u svako doba da razmotre pitanja od interesa za lokalitet i sastavljaju i usvajaju plana rada Odbora i unutrašnja pravila funkcionisanja.

10.2 Lokalni Odbor sela, naselja ili prigradskih naselja organizuje, prati i planira razvojne programe na lokalitetima u svim oblastima u saradnji sa Gradonačelnikom Opštine, komitetima i opštinkim direktoratima.

10.3 Lokalni Odbor sela, naselja ili prigradskog naselja treba da informiše Opštinu o vremenu i agendi skupova. Nadlženi opštinski službenici treba da učestvuju na skupovima koje organizuju lokalni odbori.

10.4 Skupovi sa građanima mogu se organizovati na inicijativu lokalnog odbora sela, naselja ili prigradskog naselja.

10.5 Lokalni odbor može preduzimati aktivnosti, posebno one koje utiču na:

10.5.1 Održivi ekonomski razvoj lokaliteta
10.5.2 Urbano i ruralno planiranje lokaliteta
10.5.3 Zaštita životne sredine u lokalitetu
10.5.4 Povećanje efikasnosti pri pružanju javnih usluga unutar lokaliteta

10.5.5 Obezbeđivanje elementarnih podataka za svaku porodicu na lokalitetu,prati njihovo ekonomsko i socijalno stanje i daje preporuke i predloge za podršku hovim slučajevima;
10.5.6 Održavanje groblja i javnog zelenih prostora;
10.5.7 Razvoj turizma
10.5.8 Organizovanje kulturnih i sportskih aktivnosti;
10.5.9 Saradnja sa opštinskim organima i drugim organizacijama civilnog društva za pitanja od interesa za lokalitet;
10.5.10 Organizovanje dobrovoljnih akcija za lokalitet
10.5.11 Ostvarivanje prenesenih aktivnosti, prema postupku člana 8 ovog Pravilnika.

10.6 Odlukom Gradonačelnika Opštine, jedan član lokalnog Odbora može biti deo organa za nadgledanje, ostvarivanje projekata za kapitalne investicije na njihovim lokalitetima.

10.7 Lokalni odbori sela, naselja i prigradskih naselja imaju pravo da sarađuju međusobno na teritoriji određene Opštine.

10.8 Lokalni odbori imaju pravo da podnesu pismeni zahtev nadležnim Opštinskim organima u interesu lokaliteta a opštinski organi u roku od 45 dana treba pismeno da odgovore lokalnom odboru koji je podneo zahtev.

**Član 11**

11.1.Lokalni odbor treba u roku od 30 dana od dana sonivanja, da organizoje izbor lokalih Podorbora u vako selo i naselje.
11.2.Lokalni Pododbori, se biroju u istom postupku kao shto se biraju lokalni odbori, gde učestvojavnje na izboru treba da bude najmanje 20 gradjana sa pravom glasa.
11.3.Pododbori broje 3 do 5 članova.

**Član 12**
**Uloga Predsedavajućih lokalnih odbora**

12.1 Predsedavajući Lokalnog Odbora predstavlja selo, naselje ili prigradsko naselje na konsultacijama i raspravama sa opštinskim organima. Predsedavajući Odbora ima obavezu da informiše članove Odbora o rezultatima ili zaključcima sa sednica iz prethodnog člana.

12.2 Predsedavajući Lokalnog Odbora saziva i vodi sednicu Lokalnog Odbora i brine o organizaciji i radu odbora. Takođe, potpisuje zaključke i predloge usvojene od strane Odbora i ima obavezu da ih u roku od 15 dana od dana usvajanja dostavi Gradonačelniku Opštine.

**Član 13**
**Finansiranje aktivnosti**

13.1 Finansiranje aktivnosti lokalnih odbora mogu izvršiti sami stanovnici sela, naselja ili prigradskog naselja, Opština, zajedničko finansiranje sa donatorima, u potpunom skladu sa Statutom, opštinskim pravilnicima i zakonodavstvom na snazi u Republici Kosovo za upravljanje javnim finansijama.

13.2 Lokalni odbor priprema šestomesečne i godišnje izveštaje o prikupljenim sredstvima i čini ih transparentnim za građane tog lokaliteta i opštinske organe.

**Član 14**
**Naknada za Lokalne Odbore**

14.1 Naknada predsedavajućim Lokalnih Odbora, naselja i prigradskih naselja određuje se posebnom odlukom Skupštine Opštine.

**Član 15**
**Neispunjavanje obaveza**

15.1 Lokalni Odbor sela, nalja i prigradskog naselja ima zakonsku obavezu i zadatak da obavlja sve aktivnosti koje su im delegirane od strane Skupštine Opštine.

**Član 16**
**Prelazne i konačne odredbe, stavljanje van snage**

16.1 U slučaju konflikta ovog Pravilnika sa Zakonom o Lokalnoj Samoupravi i Statutom Opštine, prednost imaju odredbe Zakona ili Statuta.

16.2 Stupanjem na snagu ovog Pravilnika, stavlja se van snage Pravilnik o Organizaciji i Funkcionisanju Lokalnih Odbora u Opštini Peć, I.br:06-2600 od dana 14. Maja 2013 i Opštinski Pravilnik br.04/2015 o Izmeni i Dopuni Pravilnika I.br. 06-2600 od 14. Maja 2013 o Organizaciji i Funkcionisanju Lokalnih Odbora u Opštini Peć.

**Član 17**
**Dopune, izmene i primena**

17.1 Eventualne izmene i dopune ovog Pravilnika izvršiće se po istom postupku kao i za usvajanje ovog Pravilnika.

17.2 Za primenu ovog Pravilnika zadužen je Gradonačelnik Opštine i Direktor Administracije.

**Član 18**
**Stupanje na snagu**

18.1 Ovaj pravilnik stupa na snagu 15 dana posle registrovanja u Kancelariji za Protokolisanje u Ministarstvu za Administraciju Lokalne Vlasti i 7 (selam) dana nakon objavljivanja na službenoj web stranici Opštine.

**PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE**
**Dr.Islam Husaj**